



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 160, datë 14.04.2021**

**PËR**  
**LEHTËSIM TË NGARKESËS SË GJYQTARES SË KOLEGJIT ZGJEDHOR**  
**GJYQËSOR, ZNJ.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 174/a, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61 dhe 89, shkronja b) të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 23 dhe 25 pika 3, shkronja dh) të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 26 pika 1 shkronja c) të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 149, pika 2 të Kodit Zgjedhor, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtares {...}, protokolluar me aktin nr. 327/4 prot, datë 25.03.2021, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Lehtësimin e ngarkesës së gjyqtares së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, znj. {...}, për shkak të thirrjes së saj në detyrë për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme në Kuvendin e Shqipërisë, nëpërmjet:
  - përjashtimit tërësisht nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve urgjente, për të cilat dispozitat procedurale parashikojnë se duhet të vendoset brenda 14/ditëve nga regjistrimi i çështjes në gjykatë;
  - pjesëmarrjes së gjyqtares në procedurat e ndarjes së çështjeve të tjera me short në masën 50 %;
2. Efektet e masave lehtësuese të ngarkesës së gjyqtares të parashikuara në pikën 1 fillojnë në datën 19.04.2021, me një kohëzgjatje deri në 3 muaj.
3. Ngarkohet Zëvendëskryetari dhe Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**